



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 115/1 prot.

Shkodër, më 9.2.2023

**Lënda:** Mbi vendimin Nr.3, datë 25.01.2023 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a, neni 27 pika 5, neni 54/e/1, neni 55/3, neni 64 germa c, Ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM Nr.684 dat.2.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.433 date.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” te ndryshuar, shtojca 49, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 date.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 3, shqyrtoi *VKB Vau-Dejës Nr.3 datë 25.01.2023 “Mbi miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, sipas dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.491prot datë 30.01.2023.*

Me anë të kësaj vendimmarrjeje Këshilli Bashkiak është vënë në dijeni parimisht për dhënien e ngastrave pyjore sipas listës së miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Relacionin nr.65prot., datë 19.12.2022 sipas propozimit nga sektori përgjegjës për pyjet dhe kullotat në bashki.

Për sa trajtuar, për procedurat e dhënies në përdorim sipas kërkesave të subjekteve pyjore, Këshilli Bashkiak duhet të shprehet rast pas rasti me një vendimmarrje të veçantë.

Konstatohet pasaktësi te listat beshkëlidhur vendimit, specifikisht te ekonomia pyjore Gomsiqe, ngastrat nr.72, ngastra nr.92 dhe ngastra nr.93, janë jo sipas listës së VKM Nr.684 datë 2.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.433 date.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” të ndryshuar, në të cilën citohet ngastra nr. 72/a,nr. 72/b, nr.92/a, nr.93/a- (në vemendje struktura përgjegjëse).

Për sa trajtuar, Prefekti autorizon procedim sipas korrigjimeve.

Duke ju falenduar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT, DHE MROJTJES SË MJEDISIT**

**V E N D I M**

Nr. 03 datë 25.01.2023

**Për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim.**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e, l" neni 18, pika 2, të Ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25, pika 1 e Ligjit nr 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet", pika 49 e VKM-së nr 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit e të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

**V E N D O S I**

1. Miratimin e ngastrave/nëngastrave të fondit pyjor të gatshme për dhënie në përdorim sipas listës së inventarit dhe hartave bashkëlidhur.
2. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti, sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
3. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, Turizmit, dhe mrojtjes së mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**K R Y E T A R**  
**MARK BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkëfak  
**ARDIAN ÇELEPIJA**

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 27.01.2023